



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 172/5 prot.

Datë 13.02.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 256/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (shërbim)”, me nr. REF-69404-11-19-2025, me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”, me fond limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 04.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me Nipt. K71903025A dhe adresë: Rruga “Shyqyri Bexholli”, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

*Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (shërbim)”, me nr. REF-69404-11-19-2025, me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”, me fond limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 04.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë..

II.2. Në datën 04.12.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 24.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Optima Communication” SHPK	7 990 000 lekë	kualifikuar
--------------------------------	----------------	-------------

II.4. Në datën 24.12.2025, në zbatim të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, autoriteti kontraktor nëpërmjet SPE i ka kërkuar operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK kërkesën me objekt “Kërkesë për dorëzim dokumentacioni provues për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim fushatë komunikimi/ndërgjegjësimi”, nëpërmjet së cilës i kërkon paraqitjen e dokumentave provuese për vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të cilat duhet të dorëzohen si brenda orarit zyrtar te datës 29.12.2025 pranë Zyrës së Prokurimeve, Bashkia Tiranë.

II.5. Në datën 12.01.2025, mbas vlerësimit të dokumntacionit të dorëzuar më datë 29.12.2025 pranë autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK është njoftuar elektronikisht për rivlerësimin e procedurës, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik “Optima Communication” sh.p.k nuk përmbush Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i zbatimit të kontratës pika 2.11 si dhe referuar Termave të Referencës pika 7 ku përcaktohet se: ‘Prezantimi i konceptit do të zhillohet gjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore, ku secila nga temat përkatëse do të trajtohen në një periudhë tre (3) mujore...’ .Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomik “Optima Communication” sh.p.k në pikën 2 Struktura Tematike dhe Organizimi i Fushatës përcaton se: “Fushata konceptohet si proces 10 mujor, i ndarë në katër faza nga 2.5 muaj...” si dhe ne piken 7 Plani i punes dhe dokumenti teknik percakton se :”Projekti do te zbatohet ne kater faza tre mujore ..” cka bie në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit dhe termat e referencës”*

II.6. Në datën 15.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Anullimit” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me argumentimin se “në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”.

II.6. Në datën 20.01.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6263, dhe me Nr. 172/2026 Prot., datë 21.01.2026 e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

**“...ARGUMENT 1**

*Eshte thelbesore te sqarojme se:*

*DOKUMENTAT TEKNIKE PER TE CILAT AK PRETENDON SE JANE ARSYE PER SKUALIFIKIM (“pika 2. Struktura tematike dhe organizative e fushatës” dhe “pika 7 plani i punës dhe dokumenti teknik”) JANE DOKUMENTA TE CILAT JANE PARAQITUR NGA ANA JONE NE OFERTIMIN ON LINE NE SPE. AK eshte njohur me keto dokumenta, si edhe me cdo dokument tjeter te paraqitur nga ana jone ne oferten elektronike, qe ne momentin e hapjes se ofertave me date 04.12.2025 (sipas afatit te percaktuar ne DST: Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:*

Data: 4/12/2025 ora 10:00), i ka studiuar dhe i ka vleresuar keto dokumenta dhe nuk ka pasur asnje pretendim, dhe ne daten 24.12.2025 ka publikuar klasifikimin dhe vleresimin e ofertave, ky kompania jone eshte ofertues i vetem dhe i kualifikuar i rregullt.

3 (tre) anetaret e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, per 20 (njetzet) dite, nga data 04.12.2025 (data e hapjes se ofertave) deri ne daten 24.12.2025 (data e publikimit te klasifikimit), kane shfrytezuar te gjitha afatin e lejuar nga ligji per vleresimin e ofertes se paraqitur nga ana jone, dhe te tre bashke, pas 20 ditesh periudhe vleresimi, kane arritur ne perfundimin se oferta jone ploteson te gjitha kushtet dhe kriteret per kualifikim, si edhe kane bere vleresimin me pike sipas kriterëve te percaktuara ne DST:

#### 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X Sipas rëndësisë:

Kriteret e Vleresimit

Pikët

(i) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit.

[0 - 20]

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.

Shënim; Autoriteti përgjegjës rezervon të drejtën që nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.

(i) Çmimi më i ulët

[0 - 50]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) Cilësia

[0 - 30]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shmebull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Kjo do te thote se secili nga tre anetaret e KVO ka bere vleresim te detajuar te ofertes se paraqitur ne SPE, duke dhene piket per secilin kriter, dhe nder kriteret ishte edhe "Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit, 0-20 pike", pra eshte bere edhe vleresimi i detajuar me pike i afatit te zbatimit, dhe ne perfundim te tre anetaret e KVO kane arritur ne perfundimin se afati i ofruar nga ana jone dhe gjithë dokumentacioni permbush kerkesat e procedures dhe nuk ka asnje shkelje/arsye per skualifikim.

KVO ka dale me klasifimin e dates 24.12.2025, ku oferta jone eshte kualifikuar e rregullt, pasi permbush te gjitha kerkesat e procedures. Te gjitha dokumentat e paraqitura ne ofertimin elektronik ne date 04.12.2025 nga ana jone jane vleresuar te rregullta nga AK dhe nuk pati asnje pretendim per asnje dokument.

#### ARGUMENT 2

Pas klasifikimit te dates 24.12.2025, dorezuar dokumentat ne rruge shkresore me date 29.12.2025, ku benin pjese edhe dokumentat qe kishim paraqitur ne ofertimin elektronik, pra benin pjese edhe dokumentat teknike per te cilat AK tani pretendon se jane arsye per skualifikim. Dokumentat teknike te dorezuara ne rruge shkresore jane IDENTIKE me dokumentat teknike te dorezuara elektronikisht ne SPE.

*NE KLASIFIKIM E DYTE, ATE TE DATES 12.01.2026, AK NA KA SKUALIFIKUAR BAZUAR MBI DOKUMENTAT TEKNIKE QE KISHIM DOREZUAR NE RRUGE SHKRESORE ME 29.12.2025 TE CILAT JANE IDENTIKE ME ATO TE DOREZUARA ELEKTRONIKISHT. Pra*

*dokumentat teknike per te cilat AK pretendon se jane arsye per skualifikim ishin paraqitur ne ofertimin elektronik te dates 04.12.2025, si rrjedhoje ato jane vleresuar me klasifikimin e dates 24.12.2025, dhe pas kesaj date gjendemi ne kushtet e “gjëse se gjykuar”.*

*NE DATEN 29.12.2025 KUR NE PARAQITEM DOKUMENTAT NE FORME SHKRESORE, AK NUK MORI ASNJE INFORMACION TE RI PER TE CILIN NUK ISHTE NE DIJENI ME PARE SA I PERKET DOKUMENTAVE QE PRETENDOHEN NGA AK SI OBJEKT PER*

*SKUALIFIKIM. Ne keto kushte permbajtja e ketyre dokumentave eshte shqyrtuar dhe vleresuar me pare dhe ne kushtet e gjese se gjykuar nuk mund te ngrihen me pretendime per to.*

*Ne nje suate krejtesisht te njejte, kur nje AK ngriti pretendime per dokumentacionin shkresor te paraqitur nga ana jone, i cili ishte identik me ate te paraqitur ne forme elektronike ne ofertimin on line ne SPE, Komisioni i Prokurimit Publik ne Vendimin Nr. 1539/2025, date 28.10.2025 (bashkangjitur), argumentoi se ligji ka krijuar garanci procedurale per te gjitha palet ne proces, si dhe ka percaktuar qartesisht afate te detyrueshme per zbatim si nga OE ashtu edhe nga AK:*

*III.2.5. Në rastin konkret, nisur nga arsyet e skualifikimit, si dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP VËREN, SE MOMENTI PROCEDURAL I VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË DOKUMENTEVE TË OFERTËS NË SPE, NGA ANA E AUTORITETIT KONTRAKTOR, NË PËRMBUSHJE TË KRITEREVE TË TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (JO DOKUMENTACIONI I DEKLARUAR NË FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT) PËR OPERATORIN EKONOMIK “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, DUHET TË ISHTE DATA 09.06.2025, DATË NË TË CILËN REFERUAR SISTEMIT PROKURIMEVE ELEKTRONIKE REZULTON TË JETË PËRMBYLLUR PROCESI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE NGA ANA KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE. Nga vlerësimi rezultoi se në atë kohë ankimuesi ka qenë i skualifikuar me arsyet e skualifikimit cituar në pikën II.5. të këtij Vendimi.*

*KOMISIONI THEKSON SE LIGJVËNËSI, NË VARËSI TË LLOJIT TË PROCEDURËS, KA PARASHIKUAR NJË AFAT KOHOR (20 OSE 15 DITË) PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË OFERTAVE DUKE DHËNË GARANCI PËR SECILËN PREJ PALËVE, KVO nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që pas procesit të vlerësimit të oferave dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraprak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP.*

*NË KËTË KUADËR KPP GJYKON, SE BRENDA PERIUDHËS KOHORE QË LIGJI PARASHIKON, KVO E AUTORITETIT KONTRAKTOR KA PATUR NË DIPOZICION MOMENTIN PROCEDURAL PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE APO SQARIMEVE TË NEVOJSHME PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, DERISA TË KONKLUDONTE ME MBYLLJEN E PROCESIT TË VLERËSIMIT NË SISTEMIN*

*E PROKURIMIT ELEKTRONIK me datë 09.06.2025, ku operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK rezultoi i kualifikuar në përmbushje të kriterëve të veçanta për kualifikim 2.2.1, 2.3.2., 2.3.3, 2.3.7, në përmbushje të të cilëve operatori ekonomik sipas vlerësimit të KVO-së*

*i ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit, me dokumentet e depozituar në SPE.*

*PËRSA KONSTATUAR KOMISIONI GJYKON SE AUTORITETI KONTRAKTOR KA PATUR NË DISPOZICION MOMENTIN PROCEDURAL DERI ME DATË 09.06.2025, KUR KA PËRFUNDUAR PROCESI I VLERËSIMIT NË SPE DHE NJOFTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË PJESËMARRËS MBI VLERËSIMIN PËR T'U SHPREHUR NË LIDHJE ME PËRPUTHSHMËRINË E DOKUMENTEVE TË OPERATORIT EKONOMIK NË SPE ME KRITERET PËR KUALIFIKIM TË PËRCAKTUAR NË DOKUMENTET E TENDERIT.*

*LEGJISLACIONI I PROKURIMIT PUBLIK E PËRCAKTON NË MËNYRË TË QARTË QË NJË OFERTË KONSIDEROHET E VLEFSHME VETËM NËSE AJO PËMBUSH TË GJITHA KËRKESAT PËR KUALIFIKIM, FAKT TË CILIN KVO E AUTORITETIT KONTRAKTOR E KA SHPREHUR ME VLERËSIMIN E OFERTAVE, ku operatori ekonomik "Optima Communicatin" SHPK nuk rezulton i skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve për kualifikim 2.2.1,2.3.2, 2.3.3 dhe 3.3.7, por skuafikuar për mospërmbushje kriteri 2.3.4, dhe pas ankesës së operatorit, u kualifikua me Vendimin 953/2025, dt.24.07.2025 të KPP-së.*

*PARIMI I LIGJSHMËRISË ËSHTË NDËR PARIMET KRYESORE TË VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, GJITHASHTU, NDËR PARIMET KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. TËRËSIA E ELEMENTEVE TË MËSIPËRME LIDHET NGUSHTËSISHT ME ELEMENTE TË LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE.*

*Sa më sipër konstatuar dhe argumentuar, Komisioni gjykon se, Vendimi i KVO-së në lidhje me skualifikimin e ankimesit me arsyet e skualifikimit 2,3,4,5,6,7,8,16 dhe 17, në këtë faze të procedurës së prokurimit, nuk qëndron.*

*Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.*

*Sikurse argumenton me lart Komisioni Prokurimit Publik, në mënyrë të detajuar mbi baza ligjore, skualifikimi i ofertës tone me datë 12.01.2026, për të njëjtat dokumenta që ishte kualifikuar me datë 24.12.2025, është i paligjshëm, i pabazuar në ligj, i paargumentuar, shkel parimin e ligjshmerisë së procedurave të prokurimit publik në vecanti, por edhe të ligjshmerisë së vendimeve të administratës publike në teresi. Për cdo paqartësi AK kishte në dispozicion të gjithë afatin e nevojshëm si edhe detyrimin ligjor për të kërkuar sqarime nga OE PERPARA se të perfundonte vlerësimin e ofertave me klasifikimin e datës 24.12.2025, prandaj kërkojme kualifikimin e ofertës tone të rregullt, pasi skualifikimi është bërë në kushtet e paligjshmerisë.*

*Garancia procedurale dhe afatet ligjore janë thelbi i kuadrit ligjor. Ashtu sikurse nuk tolerohet për OE që të kapërcejnë afatet ligjore, njelloj AK nuk mund të nxjerrë vendime përtej afateve procedurale që i ka caktuar ligji. Dhe sipas ligjit, afati i AK për vlerësimin e dokumentave të paraqitura në rrugë elektronike perfundoi me datë 24.12.2025 kur u shpall klasifikimi i pare. Pas kësaj date AK nuk mori asnjë informacion të ri mbi dokumentat që përmend në arsyen për skualifikim, dokumentat shkresore ishin identike me ato që AK kishte vlerësuar si pjesë e ofertës elektronike.*

### **ARGUMENT 3**

*Në këtë procedurë mënyra e vlerësimit ishte përcaktuar:*

#### **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X Sipas rëndësisë:**

*Kriteret e Vleresimit*

*Pikët*

(i) *Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit.*

*[0 - 20]*

*Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.*

*Shënim; Autoriteti përgjegjës rezervon të drejtën që nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.*

(i) *Çmimi më i ulët*

*[0 - 50]*

*Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.*

(ii) *Cilësia*

*[0 - 30]*

*Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shmebull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.*

*Sikurse përkruhet ne Kriteret e Vleresimit:*

*Kriteret e Vleresimit*

*Pikët*

(i) *Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit.*

*[0 - 20]*

*Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.*

*Shënim; Autoriteti përgjegjës rezervon të drejtën që nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.*

*Ne shenimin që vete AK ka vendosur për këto kriter, sqarohet se OE është i lire të ofrojë një afat zbatimi sipas propozimit të tij, edhe me të ulët se afati 12 mujor i përcaktuar nga AK, por në rast se ky afat do të ishte më pak se 80% e afatit të përcaktuar në DST, AK do të kërkonte sqarimet përkatëse nga OE.*

*Vleresimi me pike tregon se një OE që ofron një afat me të shkurter vlerësohet me më shumë pike, sikurse shpjegohet edhe në "Udhëzimet për Operatorët Ekonomike" në DST:*

*Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:*

*Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

*Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:*

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

*P<sub>o</sub> - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar*

*P<sub>k1</sub>/P<sub>k2</sub>/P<sub>k3</sub>/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend*

zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$  \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$  \_\_\_\_\_ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po

vlerësohet  $Pmaxk1$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i

jepen kriterit që vlerësohet  $Ok1$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për

kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmaxk1$$

$Vmaxk1$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$Pmaxk1$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Duke qene se oferta e paraqitur nga kompania jone ishte oferta e vetme e paraqitur ne tender, afati i levrimit i paraqitur nga ana jone ka qene njekoheisht edhe afati me i mire i ofertuar.

Pra afati 12 mujor jo vetem qe nuk eshte detyruet, por kushdo OE qe ofron afat me te shkurter vleresohet me me shume pike. E rendesishme eshte te mos kapercehet afati 12 mujor I percaktuar nga AK.

Ne keto kushte, nuk kemi bere asnje shkelje ne kete procedure pasi nuk kemi ofruar nje afat me te gjate se 12 muaj, dhe as nuk kemi ofruar nje afat me te shkurter sesa 80% e afatit 12 mujor (80% e 12 muajve = 9.6 muaj).

AK ka sqaruar vete se nje afat me pak se 80% e afatit te parashikuar 12 mujor, mund te ishte arsye per kualifikim apo skualifikim te OE, por edhe ky vendim do te merrej pasi ti kerkoheshin sqarime OE. Pra edhe ne rastin e nje afati me te shkurter se 80% e afatit 12 mujor, AK fillimisht do te kerkonte sqarime, pastaj do te merrte vendim nese do ta skualifikonte nje OE.

Nese AK kishte ndonje paqartesi per afatin e ofruar nga ana jone, kishte detyrimin, sipas shenimit qe ka bere vete, por edhe sipas percaktimeve ligjore dhe shume udhezimeve dhe vendimeve te Komisionit te Prokurimit Publik dhe Agjencise se Prokurimit Publik, qe te na kerkonte sqarime perpara se te na skualifikonte.

Edhe nje here arsyeja e skualifikimit nuk qendron, kemi gjithë te drejten te ofrojme nje afat me te shkurter sesa afati maximal i percaktuar 12 muaj ne DST.

#### ARGUMENT 4

Ne cdo rast, cdo afat i propozuar nga OE ne harkun kohor nga 9.6 muaj deri ne 12 muaj, do te sillte vetem ndryshimin e pikeve ne vleresimin e ofertes, dhe nuk eshte arsye per skualifikim. AK eshte i detyruar te vleresoje ofertat vetem mbi kriteret qe ka percaktuar ne DST. Per sa kohe qe nuk eshte kriter per skualifikim nje afat me i shkurter se 12 muaj, atehere nuk ka arsye te skualifikohet oferta e dhene nga kompania jone.

Per me teper, si ne klasifikimin e pare ku oferta jone ishte e kualifikuar, ashtu edhe ne klasifikimin e dyte ku oferta jone eshte skualifikuar, ne te dyja rastet oferta jone eshte vleresuar njelloj me 93.9 pike, pa asnje ndryshim ne piket e fituara.

Nese afati i levrimit i propozuar nga ana jone do te kishte parregullsi, duhej te ishin zvogeluar edhe

*piket me te cilat vleresohet ky afat, dhe ne klasifikimin e dyte duhej te kishim me pak pike, duhej te na ishin zbritur piket qe i perkasin afatit te levrimit, nderkohe jemi vleresuar njelloj me 93.9 pike edhe ne klasifikimin e dyte. Fakti qe piket e dhena nga AK per levrimin mbeten njelloj, do te thote qe nuk ka ndonje parregullsi me afatin e levrimit te propozuar nga ana jone.*

#### **ARGUMENT 5**

*Sipas “Udhezimeve per Operatoret Ekonomike” ne DST, vleresimi i ofertave nis me “Kualifikimin e operatoreve ekonomike” dhe me pas vijohet me “Kriteret e percaktimit te ofertes fituese” pra me vleresimin me pike. Vleresimi me pike i ofertave behet pasi kalohet faza e kualifikimit, pra pasi eshte gjykuar se ofertat kane plotesuar kriteret e procedures dhe nuk ka arsye per skualifikim. Ne rast se nje oferte ka arsye te skualifikohet, atehere ajo skualifikohet dhe nuk eshte me nje oferte e kualifikuar/ e vlefshme per te vijuar me vleresimin e pikeve. Ne klasifikimin e dyte te dates 12.01.2026 ku AK pretendon se e ka skualifikuar oferten e paraqitur nga kompania jone, oferta jone perseri eshte vleresuar me 93.9 pike.*

*Nese do te kishte nje arsye per skualifikim, oferta jone nuk duhej te kishte kaluar fare ne fazen e perllogaritjes se pikeve. Fakti qe edhe ne klasifikimin e dyte te dates 12.01.2026 oferta jone ka marre 93.9 pike do te thote qe faza e kualifikimit eshte kaluar me sukses dhe nuk ka arsye per skualifikim.*

*Argumenti qe sqaruar ne kete pike, mbeshtetet ne nenin 82 Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave, i Rregullave te Prokurimit Publik, VKM nr 285, date 19.05.2021, i ndryshuar:.....”*

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 172/1 prot., datë 22.01.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 172 prot, datë 21.01.2026.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 5843 prot., datë 10.02.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 172/2 prot., datë 12.02.2026, me objekt “Lidhur me ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjësimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

### **Arsyeton**

III.1 Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e tij me argumentimin se *“nuk përmbush Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i zbatimit të kontratës pika 2.11 si dhe referuar Termave të Referencës pika 7 ku përcaktohet se: ‘Prezantimi i konceptit do të zhillohet gjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore, ku secila nga temat përkatëse do të trajtohen në një periudhë tre (3) mujore...’.*Nga verifikimi i dokumentacionit , rezulton se Operatori Ekonomik “Optima Communication” sh.p.k në pikën 2 Struktura Tematike dhe Organizimi i Fushatës përcaton se: *“Fushata konceptohet si proces 10 mujor, i ndarë në katër faza nga 2.5 muaj....”* si dhe në pikën 7 Plani i punës dhe dokumenti teknik përcakton se :*“Projekti do të zbatohet në katër faza tre mujore ..”* cka bie në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit dhe termat e referencës.””, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Seksionin 2, “Objekti i Kontratës” në pikën 2.11 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“ 2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:  
Kohëzgjatja në muaj 12 ose ditë □□□ ”*

III.1.2. Në Seksionin 4, “Procedura” në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

#### *4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:*

A) <sup>1</sup>*Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X*

*Sipas rëndësisë:*

*Kriteret e Vlerësimit*

*Pikët*

(i) *Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit.*

*[0 - 20]*

---

<sup>1</sup> *Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.*

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.

Shënim; Autoriteti përgjegjës rezervon të drejtën që nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.

(ii) Çmimi më i ulët [0 - 50]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(iii) Cilësia [0 - 30]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shmebull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

□

### OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuader përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

III.1.3 Në shtojcën 8 “TERMAT E REFERENCES” të dokumenteve standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ndër të tjera në pikën 7 ka përcaktuar si më poshtë:

#### “.....7. PREZANTIMI I KONCEPTIT

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, operatori ekonomik është i detyruar të paraqesë në fillim të çdo faze për secilën temë prezantimin e detajuar të punës, e cila do t'i nënshtrohet procesit të shqyrtimit dhe miratimit nga Drejtoria e Mjedisit, Parqeve dhe Rekreacionit. Vetëm pas miratimit zyrtar të këtij prezantimi, operatori do të mund të vijojë me zbatimin e aktiviteteve sipas fazave të parashikuara. Prezantimi i konceptit do të zhvillohet gjatë një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore, ku secila nga temat përkatëse do të trajtohen në një periudhë tre (3) mujore, në përputhje me planifikimin dhe renditjen e përcaktuar më poshtë.

FAZA I: PASTËRTIA URBANE DHE RURALE (3 muaj)  
Aktivitetet mujore

*Muaji 1: Gjatë këtij muaji do të realizohet prezantimi i konceptit të projektit duke përcaktuar objektivat, fushat kryesore të veprimit dhe pritshmëritë me qëllim krijimin e një kuadri të qartë orientues për zbatimin e mëtejshëm.*

*Muaji 2: Prodhimi i spotit në media (përfshirë media buying), publikimi i 4 videove edukative në rrjete sociale, krijimi i 2 infografikëve&animacioneve informuese, realizimi i një fushate me një figurë publike me ndikim për promovimin e praktikave të riciklimit dhe ripërdorimit, si dhe vendosja e 5 grafikave outdoor me mesazhe sensibilizuese.*

*Muaji 3: Vijimi i publikimit të spotit sipas planit të muajit 2, publikimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, krijimi i 3 infografikëve&animacioneve informuese, organizimi i një eventit për riciklimin dhe ripërdorimin, vendosja e 5 grafikave outdoor. Në fund të muajit përgatitet raportimi tremujor përmbledhës për Fazën I.*

## **FAZA II: MOBILITETI I QËNDRUESHËM (3 muaj)**

*Aktivitetet mujore*

*Muaji 4: Gjatë këtij muaji do të realizohet prezantimi i konceptit të projektit duke përcaktuar objektivat, fushat kryesore të veprimit dhe pritshmëritë me qëllim krijimin e një kuadri të qartë orientues për zbatimin e mëtejshëm.*

*Muaji 5: Prodhimi i spotit në media (me përfshirjen e media buying), publikimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, krijimi i 2 infografikëve&animacioneve informuese, realizimi i një fushate me një figurë publike me ndikim, organizimi i një eventit publik dhe vendosja e 5 grafikave outdoor.*

*Muaji 6: Vijimi i publikimit të spotit, prodhimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, krijimi i 3 infografikëve&animacioneve informuese me statistika dhe këshilla praktike për transport të gjelbër, ecjen dhe përdorimin e biçikletës si formë e transportit miqësor me mjedisin, vendosja e 5 grafikave outdoor dhe hartimi i raportimit tremujor përmbledhës për Fazën II.*

## **FAZA III: UJI & RUAJTJA E TIJ (3 muaj)**

*Aktivitetet mujore*

*Muaji 7: Gjatë këtij muaji do të realizohet prezantimi i konceptit të projektit duke përcaktuar objektivat, fushat kryesore të veprimit dhe pritshmëritë me qëllim krijimin e një kuadri të qartë orientues për zbatimin e mëtejshëm.*

*Muaji 8: Prodhimi i spotit në media që promovon përdorimin racional veçanërisht në lavazhe, subjekte që përdorin ujin për vaditje dhe aktivitete të tjera, publikimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, krijimi i 2 infografikëve&animacioneve informuese, realizimi i një fushate me një figurë publike me ndikim dhe vendosja e 5 grafikave outdoor me mesazhe sensibilizuese.*

*Muaji 9: Vijimi i publikimit të spotit, prodhimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, organizimi i një eventit publik me pjesëmarrje komunitare, krijimi i 3 infografikëve&animacioneve informuese, vendosja e 5 grafikave outdoor dhe hartimi i raportimit tremujor përmbledhës për Fazën III.*

## **FAZA IV: ENERGJIA E RINOVUESHME (3 muaj)**

*Aktivitetet mujore*

*Muaji 10: Gjatë këtij muaji do të realizohet prezantimi i konceptit të projektit duke përcaktuar objektivat, fushat kryesore të veprimit dhe pritshmëritë me qëllim krijimin e një kuadri të qartë orientues për zbatimin e mëtejshëm.*

*Muaji 11: Prodhimi i 1 spoti edukativ për promovimin e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe veprimet konkrete që reduktojnë emetimet e gazeve serrë, publikimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, krijimi i 2 infografikëve&animacioneve informuese, realizimi i një fushate me një figurë publike me ndikim dhe vendosja e 5 grafikave outdoor me mesazhe sensibilizuese.*

*Muaji 12: Vijim i publikimit të spotit, prodhimi i 4 videove edukative për rrjete sociale, krijimi i 3 infografikëve&animacioneve informuese, vendosja e 5 grafikave outdoor shtesë, organizimi i një eventit final përmbyllës, raportimi tremujor për Fazën IV dhe raportimi përfundimtar për të gjithë projektin.*

*Fushata do të zgjasë 12 muaj dhe do të ndahet në 4 faza tremujore, secila e përqendruar në një temë specifike dhe me objektiva të qarta.....”*

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- OC\_Fushata\_e\_Komunikimit\_dhe\_ndergjegjesimit\_plani\_i\_punes\_dhe\_dokumenti\_teknik

Në këtë dokument lidhur me grafikun e zbatimit ka përcaktuar si më poshtë:

#### *[....] 7. GRAFIKU I ZBATIMIT*

*Projekti do të zbatohet në katër faza 2.5 mujore (totali: 10 muaj), ku secila fazë do t’i kushtohet një teme specifike dhe do të përfshijë prodhimin e spoteve audiovizive, videove edukative, infografikëve dhe animacioneve, organizimin e eventeve komunitare dhe vendosjen e grafikave outdoor. Faza e parë i dedikohet pastërtisë urbane dhe rurale; faza e dytë mobilitetit të qëndrueshëm; faza e tretë ruajtjes së ujit dhe përdorimit racional të tij; ndërsa faza e katërt energjisë së rinovueshme. Secila faze do të përfundojë me një event final, me raport për secilën fazë dhe në fund do dorëzohet raporti përfundimtar.....[....]*

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe

*në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, parrënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...*”

III.1.8 Në nenin 4, pika 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“ 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.9. Në nenin 80, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj.

III.1.10. Në nenin 87, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

*b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.*

*4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.*

*5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.”*

III.1.11. Në nenin 92, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”*

III.1.12 Në nenin 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.*

*2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë*

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi- kohë, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë dhe kohës së realizimit të shërbimit. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si **Çmimi (50 pikë), Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit (20 pikë), cilësia (30 pikë)**, sipas dokumenteve standarde të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi - kohë, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, dhe kohën e realizimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën

ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

<b>Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit.</b>	<b>[0 - 20]</b>
<b>Çmimi më i ulët</b>	<b>[0 - 50]</b>
<b>Cilësia</b>	<b>[0 - 30]</b>

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të ofertës ekonomike më të favorshme, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet t'i nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dyplanëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët e tjerë ekonomikë, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme, lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe metodologjia që favorizojnë kohën e realizimit të këtij shërbimi. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik/ofertues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit.. Në rastin konkret metodologjia e paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” Shpk, referuar termave të referencës në DST përbëhet nga: metodologjia e zbatimit dhe qasja e propozimit teknik; stafi kryesor, përgjegjësia dhe organizimi; organizimi i sitit të punës; siguria dhe përputhshmëria ligjore; plni i sigurisë së cilësisë (QA/QC); plani i organizimit ; grafiku i zbatimit; menaxhimi i riskut; organizimi i projektit dhe raportimi dhe analiza e performancës. Konkretisht, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes “Optima Communication” Shpk, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, nga ana e operatorit ekonomik “Optima Communication” Shpk, në përbushje të “grafiku i zbatimi” është paraqitur në SPE materiali “Fushata e Komunikimit dhe Ndërgjegjësimi”, ku ndër të tjera evidentohet: “Grafiku i zbatimit”- *Projekti do të zbatohet në katër faza 2.5 mujore (totali: 10 muaj) .....* . Në përfundim, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar

nga ana e OE “Optima Communication” Shpk, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike për kriterin “grafiku i realizimit” të kontratës që përfshin katër faza 2.5 mujore për një afat kohor prej 10 muajsh. Nisur nga ky grafik zbatimi autoriteti kontraktor ka vendosur vlerësimin për këtë kriter me 0 (zero) pikë dhe njëkohësisht skualifikimin e operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit me argumentimin se *Operatori ekonomik “Optima Communication” sh.p.k nuk përmbush Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i zbatimit të kontratës pika 2.11 si dhe referuar Termave të Referencës pika 7 ku përcaktohet se: ‘Prezantimi i konceptit do të zhillohet gjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore, ku secila nga temat përkatëse do të trajtohen në një periudhë tre (3) mujore...’.* Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se Operatori Ekonomik “Optima Communication” sh.p.k në pikën 2 Struktura Tematike dhe Organizimi i Fushatës përcaton se: *“Fushata konceptohet si proces 10 mujor, i ndarë në katër faza nga 2.5 muaj...”* si dhe në pikën 7 Plani i punës dhe dokumenti teknik përcakton se: *“Projekti do të zbatohet në katër faza tre mujore ..”* cka bie në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit dhe termat e referencës. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë (në rastet kur nuk aplikohet përlllogaritje me formulë) megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me vlerësimin e pikëve për këtë kriter, duke analizuar propozime teknike për të cilin operatori ekonomik ka propozuar një afat kohor më të shpejtë se 12 muaj të kërkuar nga autoriteti kontraktor, çka do të thotë një realizim më të shpejtë dhe me cilësi të lartë të projektit “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjësimi”, dhe për të cilin Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vendosur skualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës “Optima Communication” SHPK, është paraqitur një metodologji e përgjithshme në përmbushje të elementëve të propozimit teknik të kërkuar nga autoritetit kontraktor. Komisioni në bazë të kohës së realizimit të shërbimit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik duhet të ishte me pikë maksimale për sa kohë që afati është më i shpejtë sesa ai i kërkuar në DST. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO nuk është kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST ku është përcaktuar që Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit vlerësohet me 0-20 pikë. Skualifikimi i operatorit ekonomik me arsyetimin se ka ofertuar me një afat realizimi më të shpejtë se ai i përcaktuar në DST nuk gjen mbështetje për sa kohë që në DST është përcaktuar që *nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit. Referuar sa më sipër dhe nisur nga propozimi i*

*operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK i cili ka ofruar një afat realizimi të shërbimit në masën 80% dhe jo më ulët se 80% të afatit të përcaktuar në DST autoriteti kontraktor jo vetëm që nuk mund ta skualifikojë por duhet ta kishte vlerësuar më pikë maksimale për këtë kriter. Procesi i pikëzimit në procedurat e tilla duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit*

### **Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK qëndron.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (shërbim)”, me nr. REF-69404-11-19-2025, me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”, me fond limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 04.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ Optima Communication” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

